



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË**

**SHKURT 2023**

**Koordinatore**  
**Erida KOLECI**

## TABELA E PËRMBAJTJES

|   |          |
|---|----------|
| <b>I. HYRJE</b> .....   | <b>3</b> |
| <b>II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT</b> .....   | <b>3</b> |
| <b>III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT</b> .....  | <b>4</b> |
| 3.1. Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit..... | 5        |
| 3.2.1. Fushat kryesore të zhvillimit profesional.....   | 5        |
| 3.2.2. Modele të testeve për AMU-në dhe për AML-në.....   | 13       |
| 3.2. Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit .                 | 35       |
| 3.2.1. Modele orësh mësimore .....  | 36       |
| 3.2.2. Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur .....  | 43       |

## **I. HYRJE**

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe në sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të shumta shkencore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre në punën e përditshme, përditësojnë njohuritë nëpërmjet hulumtimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale, si dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

## **II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT**

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- Të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe për t'u ardhur në ndihmë DRAP-eve, ZVAP-ve për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve.
- Të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

*Programi ka për qëllim që mësuesi:*

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënit, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe të ligjësive shkencore të lëndës/ve, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritetet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tij në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca, dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

### **III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:

3.1. *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihen, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, edhe dy modele testesh: një test për gjuhën shqipe në arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe një test për letërsinë në arsimin e mesëm të lartë (AML).*

3.2. *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë (Mësues mjeshtrë) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka dy modele orësh mësimore: një model ore mësimore në AMU dhe një model ore mësimore në AML. Gjithashtu janë dhënë edhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.*

### **3.1. Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit**

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe dy modele testesh: një për AMU-në dhe një për AML-në.

#### **3.2.1. Fushat kryesore të zhvillimit profesional**

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- Dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë.
- Programet lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në AMU dhe në AML.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore lëndore sipas programeve mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- Kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave.

---

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- Literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të lëndës.

Rezultatet e pritshme dhe literatura e rekomanduar për çdo fushë të zhvillimit profesionale, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

| FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”   |   |
|--|---|
| <p><b>Kompetenca:</b> Zbatimi me përgjegjshmëri dhe me korrektesë i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>  |
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron njohuri dhe aftësi për zbatimin e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li> <li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS, datë 27.07.2022.</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me udhëzimin nr.14, datë 28.07.2021.</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul> |

|  |  |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Urdhri nr. 46, datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul> |
|--|--|

| FUSHA “PROGRAMET LËNDORE TË GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË”   |  |
|---|--|
| Kompetenca: Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjuhës shqipe të dhe letërsisë në shkollë.   | Literatura e rekomanduar   |
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh dhe zbaton programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre;</li> <li>• përshtat programet lëndore në përputhje me nxënësit dhe me veçoritë e mjedisit, në të cilin jep mësim;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programeve lëndore;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive të përcaktuara në programe;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve, si dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 6-9, lënda “Gjuhë shqipe”.</li> <li>• Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 10-12, lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi” dhe “Letërsi me zgjedhje”.</li> </ul> |

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh dhe zbaton koherencën vertikale të programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë;</li> <li>• harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grupe temash, që janë në përputhje me programet lëndore;</li> <li>• përzgjedh metodat, teknikat dhe mjetet mësimore të nevojshme për të mundësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënit;</li> <li>• përcakton nivelet e vlerësimit të nxënësve duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe nivelet e arritjes të kompetencave lëndore për shkallë mësimore;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjuhës me letërsinë, me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul> |  |
|---|--|

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK -UT NË MËSIMDHËNIE**

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kompetenca 1:</b> Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>                  | <p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>   |
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018.</li> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, 2018.</li> </ul> |



|  |  |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshtat punën e tij me zhvillimin njohës, social dhe emocional të nxënësve;</li> <li>- përdor metoda, teknika dhe strategji që synojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënës;</li> <li>- identifikon nxënësit me nevoja të veçanta dhe planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me këta nxënës;</li> <li>- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj gjuhës dhe letërsisë;</li> <li>- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>- edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj gjuhës shqipe dhe letërsisë;</li> <li>- motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin, si një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>- bashkëpunon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul> |  |
| <p><b>Kompetenca 2:</b> Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>  | <p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>   |
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënës;</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018.</li> </ul> |

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin kritik e krijues të nxënësve;</li> <li>- planifikon dhe zhvillon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>- përdor metoda e teknika që ndikojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore;</li> <li>- përdor metoda dhe teknika të ndryshme mësimore që përkojnë me stilet e ndryshme të të nxënit;</li> <li>- njeh dhe zbaton gjatë procesit të të nxënit lloje të ndryshme të vlerësimit;</li> <li>- vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve;</li> <li>- përdor teknika dhe evidenca të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>- zhvillon me nxënësi teste që zbatojnë parimet e hartimit dhe të pikëzimit të një testi.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, 2018.</li> <li>- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020 Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi..</li> <li>- Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi.</li> </ul> |
| <p><b>Kompetenca 3:</b> Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies/nxënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>   | <p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>   |
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton materiale mësimore duke përdorur programe të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Materiale në ndihmë të mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> <li>- Urdhri i MAS-it nr. 84, datë 06.05.2021 “Për miratimin e standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit”.</li> </ul>                                       |

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- nxit nxënësit të bëjnë prezantime gjatë orës së mësimi duke përdorur TIK-un;</li> <li>- gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe për të përmirësuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>- përdor platforma të ndryshme online, të cilat e ndihmojnë për një proces mësimor efektiv;</li> <li>- përfshin nxënësit në projekte lëndore, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga burime të ndryshme në internet.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Materiali ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021</li> </ul> |
|---|--|

### FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

| <b>Kompetenca:</b> Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit.   | <b>Literatura e rekomanduar</b>  |
|--|--|
| <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>- zbaton rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin, gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>- Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin e MAS-it, nr.31, datë 28.01.2020.</li> <li>- Urdhri i MAS-it, nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul> |

**FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE**

| <b>Kompetenca:</b> Zbatimi i rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.  | <b>Literatura e rekomanduar</b>   |
|---|---|
| <b>Rezultatet e pritshme</b><br>Mësuesi: <ul style="list-style-type: none"><li>- njeh dhe zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li><li>- vlerëson rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde në të gjitha veprimtaritë dhe punët e tij.</li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li></ul> |

**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

| <b>Kompetenca:</b> Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.  | <b>Literatura e rekomanduar</b>  |
|---|--|
| <b>Rezultatet e pritshme</b><br>Mësuesi: <ul style="list-style-type: none"><li>- analizon dhe jep gjykimet e tij për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimet letrare, si dhe për shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare;</li><li>- kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe jo letrare;</li><li>- shkruan ese me tematika që lidhen me çështje të ndryshme arsimore;</li><li>- analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment;</li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>- Programe dhe tekste të lëndës së gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të letërsisë me zgjedhje, për nxënësin dhe për mësuesin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen lëndore për klasat 6-9 për arsimin e mesëm të ulët, si dhe për klasat 10 - 12 për arsimin e mesëm të lartë.</li></ul> |

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- kryen analiza të sakta nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes;</li> <li>- respekton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.</li> </ul> |  |
|---|--|

### 3.2.2. Modele të testeve për AMU-në dhe për AML-në

#### TEST “GJUHË SHQIPE” AMU

##### Dokumentacioni zyrtar shkollor

1. Bazuar në udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, provimi quhet i kryer me sukses nëse kandidati ka fituar të paktën: **1 pikë**
  - A) 30% të pikëve për secilën pjesë të testit.
  - B) 40% të pikëve për secilën pjesë të testit.
  - C) 50% të pikëve për pjesën e parë të testit.
  - D) 70% të pikëve për pjesën e parë të testit.
  
2. Një mësues që është i interesuar për të kuptuar se sa e përmbush standardin “Vlerësimi i të nxënit”, si një ndër standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, analizoi të gjithë treguesit e këtij standardi. Nga vlerësimi i treguesve të standardit i rezultoi që mesatarja e pikëve të tij për këtë standard ishte 2,8. Përcaktoni cilit nivel të arritjeve të standardeve të formimit të përgjithshëm të mësuesve i korrespondon kjo mesatare e pikëve. **1 pikë**
  - A) Nivelit 1
  - B) Nivelit 2
  - C) Nivelit 3
  - D) Nivelit 4
  
3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).
  - a) Referuar udhëzimit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, punonjësit arsimorë trajnohen të paktën tri ditë në vit. Tri ditë trajnimi pasqyrojnë tri kredite. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

- b) Referuar Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, në fillim të vitit shkollor, mësuesi dorëzon në drejtorinë e shkollës planin vjetor të lëndës, si edhe planin e periudhës së parë. Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë. Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar të periudhës, ndryshime të cilat miratohen nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### **Programi lëndor**

4. Për ndërtimin e kompetencave të lëndës, nxënësi punon: **1 pikë**
- A) çdo orë mësimi.
  - B) vetëm në disa orë të veçanta.
  - C) vetëm gjatë një periudhe.
  - D) vetëm gjatë një viti mësimor.
5. Shënoni me V nëse pohimi është i vërtetë, ose me G nëse pohimi është i gabuar. **3 pikë**
- a) Programi i gjuhës shqipe mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. \_\_\_\_\_
  - b) Në programin e klasës së nëntë janë sugjeruar 25 orë mësimore për përgatitjen e nxënësve për provimin kombëtar të arsimit bazë, lënda “Gjuhë shqipe”. \_\_\_\_\_
  - c) Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyç. \_\_\_\_\_
6. Përcaktoni kompetencat lëndore që u përkasin këto shkathtësi? **2 pikë**
- a) Nxënësi përzgjedh fjalët e duhura për të arritur qëllimin e tij dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.
  - b) Nxënësi vlerëson idetë që përcjell teksti, gjuhën dhe stilin e autorit, duke argumentuar mendimin e tij.

### **Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë**

7. Gjatë planifikimit të testit, hapi i parë që duhet të kryejë mësuesi, është: **1 pikë**

- A) hartimi i skemës së vlerësimit të testit.
- B) përcaktimi i llojeve të pyetjeve dhe i pikëve që do të ketë testi.
- C) përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit.
- D) përcaktimi i rezultateve të të nxënit që do të vlerësohen në test.

8. Vlerësimi i të nxënit: **1 pikë**

- A) është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
- B) ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni.
- C) mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë.
- D) synon të zbulojë shkaqet e dobësive që kanë nxënësit në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

9. Gjykoni si është formuluar dhe është pikëzuar pyetja e mëposhtme? Ç' lloj pyetjeje është ajo? **3 pikë**

Çfarë kanë të veçantë prapashtesat e fjalëve: *syçkat, gjethëzat*? Cili është funksioni i këtij përdorimi?

*3 pikë*

a) Formulimi i pyetjes:

---

b) Pikëzimi i pyetjes:

---

c) Lloji i pyetjes:

---

10. Zbatoni metodën e analizës së tipareve semantike për disa klasa fjalësh dhe kategoritë e tyre gramatikore. Shkruani dy përparësi të përdorimit të kësaj metode. **3 pikë**

a) Analiza e tipareve semantike

|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

b) Dy përparësi: \_\_\_\_\_

11. Renditni tri arsye pse mësuesit duhet të përdorin *Google Forms*. **3 pikë**

12. Plotësoni pohimet e mëposhtme. **2 pikë**

- a) Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse dhe e dorëzon në \_\_\_\_\_ para fillimit të periudhës.
- b) Plani vjetor është një plan sintetik, ndërsa plani i periudhës është \_\_\_\_\_.

### Aspekte të komunikimit dhe të etikës

13. Një klasë gjithëpërfshirëse është ajo ku: **1 pikë**

- A) vlerësimet përsëriten derisa çdo nxënës të arrijë rezultatet minimale.
- B) mësuesit japin mësim duke iu referuar vetëm tekstit mësimor për të pakësuar ngarkesën e nxënësve.
- C) ka një përfshirje aktive të nxënësve me rezultate të larta.
- D) mësuesit krijojnë për çdo nxënës praktika dhe përvoja të ndryshme të nxëni.



14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).

Në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar, janë të përcaktuara detyrat që kanë të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar për zbatimin e këtij Kodi.

a) Është detyrë e institucionit arsimor të përkthejë kodin e etikës në udhëzime, rregullore, etj. për sjelljet që duhen krijuar e mbështetur, në kushtet e veçanta të mjedisit të tij arsimor.

V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Është detyrë e institucioneve arsimore të trajnojnë të gjithë prindërit dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal për parimet dhe qëllimin e kodit të etikës. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**

### **Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe**

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë
- B) parlamenti i nxënësve të shqipërisë
- C) parlamenti i nxënësve të Shqipërisë
- D) Parlamenti i nxënësve të Shqipërisë

16. Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme. **3 pikë**

- a) Ne duhet t'i kushtojmë vëmëndje të veçantë problemit të braktisjes së shkollës për të gjetur arsyet e vërteta dhe për t'i dhënë zgjidhje.
- b) Kur nxënësi i klasave IV-IX mungon më shumë se pesë dhjetë për qind të orëve totale vjetore të planit mësimor, mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
- c) Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes, kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftushme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.

### **Përmbajtja shkencore e lëndës**

#### ***Pjesa e parë***

#### ***“Pylli” Mit’hat Frashëri***

*(Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

Njëherë fati më shtyri në një qytet mbi zall të detit Zi, në Ineboll. Sadoqë thonë se ay det është shumë her' i kuq dhe i lik, udhëtimi im kish qënë fort i këndshëm. Po e vërteta ish se dhe stina ish pranverë, ëmbëlsi dhe bukuri e motit.

.....

Inebolli ish shtrirë mbi zall, më të dy anë të limanit; shtëpitë e prapsme ngriheshin mbi një faqe, mbi piqinjt e një kodre; kodra ngjitesh bëshesh me majë dhe fare sipër kishte një godi të madhe. Padyshim një manastir, thashë se rreth godisë kish drurë, lisa të mëdhenj. Pra, kam se ç'të shoh, e di tani ku të vete.

Në udhëtime të tillë njeriu duhet të mos harrojë dy gjëra: Të kënaqet me një hotel të dobët ose me një han të mirë, edhe të dijë të kërkojë, të gjejë, të zbulojë një gjë të interesaçme, një gjë që vlen të vizitohet, një gjë që të mos thotë njeriu se humbi kohën fare kot.

Si u mbaruan godit e fundit, zinte një pyll i vogël; drurët ishin të përzjerë: veç drurëvet me pemë që lamë përposh, në pyll kish shkozë, ah, panjë, dushk, lofatë, frashër: aty këtje lar, lar i Apollonit rrëfente fisnikun dhe të fortin drun' e tij, me lëvezhgën e limuar, me fletët si majë e shigjetë. Më lart akoma kish bredha, boriga, drurë të shkurtër, po të shëndoshë: lëkur' e tyre e rrudhur dhe'e carë shtrythte lëngun e trashë, pisën e verdhë, një farë mjaltë të hidhur. Pas një sheshi të vogël, ku bari gjelbëronte dhe rrëfente ca njolla lulesh mbi kadifen e gjelbër, drurët rriteshin dhe më tepër, majat u ngjiteshin më lart, degët me gjethe u bashkoheshin.

S'di gjë më të këndshme se t'ecurët brenda në një pyll të dendur, ku trungjet lartësohen si shtyllas, kur degët dhe fletët, duke u përzjerë atje në majë, formojnë një arkitekturë gotike që s'e barazon dot kurrë mjeshtëri e njeriut; drita këtu mezi gjen një rugë nëpërmes t'atyre fletëve; sitet, kullohet thotë njeriu se pastrohet. humbet fuqinë dhe merr një ngjyrë të venitur, si drit' e agimit; një mister, një ndjenjë pikëllimi mbretëron. Edhe kuptohet lehtë pse të moçmit e kanë ardhuruar pyllin, pse e kanë mbushur me perëndi, pse atje kanë pasur vëndin e faljevet, e lutjevet, e misterevet, e shogrimevet të tyre.

*Kostamoni, 18 korrik 1912*

17. Për nga lloji ky tekst është:

- A) autobiografi.
- B) kronikë.

**1 pikë**

- C) tregim.
- D) udhëpërshkrim.

18. Cila nga fjalitë e mëposhtme demonstroi qëllimin e autorit për t'i sjellë tekstit nuanca bindëse: **1 pikë**

- A) Padyshim një manastir, thashë se rreth godisë kish drurë, lisa të mëdhenj.
- B) Pas një sheshi të vogël ku bari gjelbëronte dhe rrëfente ca njolla lulesh mbi kadifen e gjelbër, drurët rriteshin dhe më tepër, majat u ngjiteshin më lart, degët me gjethe u bashkoheshin.
- C) Po e vërteta ish se dhe stina ish pranverë, ëmbëlsi dhe bukuri e motit.
- D) S'di gjë më të këndshme se t' ecurët brenda në një pyll të dendur, ku trungjet lartësohen si shtyllas, kur degët dhe fletët, duke u përzjerë atje në majë, formojnë një arkitekturë gotike që s'e barazon dot kurrë mjeshtëri e njeriut.

19. Si do të ndryshonte kjo pjesë nëse do të shkruhej në mënyrë objektive nga perspektiva e vetës së tretë? **1 pikë**

- A) Do të fokusohet më shumë në dimensionet kohore.
- B) Do të jepte më shumë informacion për cilësitë e narratorit.
- C) Do të kishte më pak përmbajtje emocionale.
- D) Do të përmbante më pak detaje në lidhje mjedisin.

20. Cilat detaje mbizotërojnë në paragrafin e dytë? **1 pikë**

- A) Akustike
- B) Kohore
- C) Pamore
- D) Të gjitha së bashku

21. Nga pikëpamja e organizimit të tekstit, paragrafi i parë shërben si hyrje. Zbuloni dy karakteristika të tij që lidhen me strukturën e tekstit. **2 pikë**

22. Cili është mesazhi që jep autori në paragrafin e tretë? **1 pikë**

23. Në paragrafin e tretë gjeni një figurë letrare që formohet nga burime sintaksore të të shprehësisë. Zbuloni funksionin e saj. **2 pikë**

a) Figura: \_\_\_\_\_

b) Funkzioni: \_\_\_\_\_

24. Përshkruani një ndjesi që krijon tek ju si lexues, paragrafi i katërt. Shpjegoni dy nga mënyrat me të cilat autori arrin të prekë ndjeshmërinë tuaj. **3 pikë**

a) Ndjesia: \_\_\_\_\_

b) Mënyrat: \_\_\_\_\_

25. Identifikoni shqisën kryesore me anën e së cilës, autori ka paraqitur mjedisin. Argumentoni pse është kjo shqisa kryesore, duke e ilustruar përgjigjen me shembuj nga teksti. **3 pikë**

**3 pikë**

26. Zbuloni një mjet gjuhësor që përdoret në përshkrimin e mjedisit. Cila teknikë e përshkrimit nxit përfytyrimin e lexuesve? **2 pikë**

a) Mjeti gjuhësor: \_\_\_\_\_

b) Teknika: \_\_\_\_\_

–

27. Gjeni një tipar të stilit romantik në këtë tekst. **1 pikë**

### *Pjesa e dytë*

#### *Fragment nga tragjedia “Prometeu i mbërthyer” Eskili*

*(Lexoni me vëmendje vargjet dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

#### *Prometeu*

Por do vijë prap’ një ditë  
Dhe sundimtar’ i perëndive  
Nevoj’ e ashpër kur ta shtyjë  
Nga unë që jam i kryqëzuar  
Nga unë që jam i gozhduar  
Përultaz ndihmë do kërkojë  
Për të zbuluar komplotn’ e ri

Q'atij i rrezikon lavdi  
E skeptër bashkë. Por më kot  
Se nuk më zbusin fjalët mjaltë  
As kërcënimet s'më trembin  
Se kurrë s'do t'i them ç'e pret  
Pa më çliruar nga prangat mua  
Për fyerjet falje pa kërkuar  
.....

*Kori*

Për ç' faje Zeusi të dënoi kaq ashpër  
Për ç' faje Zeusi të poshtëroi kaq rëndë  
.....

28. Për fabulën e kësaj tragjodie, Eskili është mbështetur: **1 pikë**
- A) në fantazinë dhe në përvojën e tij.
  - B) në historinë e lashtë të Greqisë.
  - C) në krijimtarinë letrare të Homerit.
  - D) në mitologjinë greke.
29. Në fragmentin e mësipërm, Prometeu shfaqet: **1 pikë**
- A) i penduar.
  - B) i përulur.
  - C) i përvuajtur.
  - D) i vendosur.
30. Plotësoni: Mjeti stilistik i përdorur në vargun e parë është \_\_\_\_\_. **1 pikë**
31. Zeusi ka përdorur mënyra të ndryshme për ta bindur Prometeun të heqë dorë nga qëndrimi i tij. Gjeni dy prej tyre në fragment. **2 pikë**
32. Zbuloni në fragment një aftësi të Prometeut si perëndi. **1 pikë**
33. Çfarë simbolizojnë Prometeu dhe Zeusi në këtë tragjedi? **2 pikë**

Prometeu: \_\_\_\_\_

Zeusi: \_\_\_\_\_

### ***Pjesa e tretë***

#### ***Arsyet pse bëhet vlerësim***

*(Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

Zakonisht vlerësimi ndërmerret për arsyet e mëposhtme:

- si diagnozë e të nxënësve dhe monitorim i përparimit;
- për të vlerësuar nxënësit me nota;
- për të parashikuar arritjet në të ardhmen;
- për t'i motivuar nxënësit;
- si diagnozë e mësimdhënies;

Diagnoza e të nxënësve dhe monitorimi i përparimit janë arsyet kryesore për kryerjen e vlerësimit (Chase, 1999). Ky informacion mund të mblidhet pak nga pak nga mësuesi, duke pyetur secilin nxënës ose përmes komenteve të nxënësve. Diagnoza ndihmon çdo nxënës të kuptojë dobësitë e veta dhe e drejton mësuesin se ku t'i përqendrojë energjitë e tij në mësimdhënie.

Në shumicën e rasteve, nxënësve u vihen nota për të treguar arritjet në fund të kapitullit, sezonit, semestrit ose vitit. Mësuesi duhet të mbledhë prova të mjaftueshme që ta ndihmojnë të japë nota të sakta. Në përgjithësi, sa më shpesh të përdoret vlerësimi dhe sa më i shumëllojshëm të jetë ai, aq më i informuar do të jetë mësuesi për notat që do t'u vendosë nxënësve.

Vlerësimi mund të përdoret gjithashtu edhe për të parashikuar nëse nxënësi mund të pranohet për të vazhduar kurse në të ardhmen. Kjo është zakonisht e rëndësishme në nivelet e larta të shkollës së mesme.

Shpesh vlerësimi mund ta shtojë motivimin e nxënësve për të punuar më shumë. Kjo varet nga secili nxënës sepse disa nxënës mund të motivohen për të punuar më shumë nëse kanë një provim në të ardhmen, ndërsa disa të tjerë mund të vuajnë nga stresi i tepërt dhe/ose mund të shkurajohen.

Të dhënat e vlerësimit mund t'i ofrojnë informacion të vyer diagnostikues mësuesit- disa arsye pse ora e mësimit eci aq mirë apo dështoi plotësisht (Eisner, 1993). Ato mund të tregojnë, për shembull, se disa aspekte të përmbajtjes apo të proceseve nuk ishin kuptuar plotësisht nga nxënësit ose se materiali i paraqitur ishte tepër i vështirë apo tepër i lehtë për një klasë të caktuar.

Sigurisht, është gjithashtu e rëndësishme të mbahen parasysh ndikimet shtrembëruese që mund të ketë vlerësimi (Gipps dhe Murphy, 1994). Forma të ndryshme vlerësimi mund të nxisin lloje të veçanta të të nxënimit (për shembull të nxënimit përmendësh) dhe të zhvlerësojnë lloje të tjera, sidomos nëse këto janë të vështira të vlerësohen (për shembull të menduarit e nivelit të lartë).

*(Teksti është marrë nga “Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin” Colin J. Marsh)*

34. Qëllimi kryesor i këtij teksti është:

**1 pikë**

- A) të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të nxënësve.
- B) të informojë rreth arsyeve pse bëhet vlerësimi i nxënësve.
- C) të përshkruajë hapat e procesit të vlerësimit të nxënësve.
- D) të udhëzojë mësuesit për vlerësimin e nxënësve.

35. Struktura e tekstit është:

**1 pikë**

- A) e krahasim- kontrastit.
- B) e problem- zgjidhjes.
- C) e shkak- pasojës.
- D) e renditjes së dukurive.

36. Për nga formimi fjala përmes në fjalinë: “Ky informacion mund të mblidhet pak nga pak nga mësuesi, duke pyetur secilin nxënës ose përmes komenteve të nxënësve”, është:

**1 pikë**

- A) kompozitë.
- B) me konversion.
- C) me përngjitje.
- D) me prejardhje.

37. Funksioni i paskajores në fjalinë: “*Shpesh vlerësimi mund ta shtojë motivimin e nxënësve për të punuar më shumë.*” është: **1 pikë**

- A) përcaktor me bashkim.
- B) përcaktor me drejtim.
- C) rrethanor qëllimi.
- D) rrethanor shkaku.

38. Sipas autorit, çfarë duhet të bëjë mësuesi para se të vlerësojë me notë nxënësit?

**1 pikë**

39. Pse fjalët e nënvizuara në fjalinë: “*Ato mund të tregojnë se disa aspekte të përmbajtjes apo të proceseve nuk ishin kuptuar plotësisht nga nxënësit*”, janë gjymtyrë homogjene? Cili funksioni i tyre?

**2 pikë**

40. Përcaktoni gjininë e fjalës së nënvizuar në fjalinë: “*Diagnoza e të nxënit dhe monitorimi i përparimit janë arsye kryesore për kryerjen e vlerësimit*”.

**1 pikë**

### ***Pjesa e katërt***

41. Nxënësit duhet të marrin më pak apo më shumë detyra shtëpie sesa bëjnë aktualisht? Argumentoni në formë eseje qëndrimin tuaj.

**6 pikë**

| <b>Idetë ose përmbajtja</b> | <b>Struktura dhe organizimi</b> | <b>Stili dhe origjinaliteti</b> | <b>Larmia dhe saktësia gjuhësore</b> | <b>Totali i pikëve</b> |
|-----------------------------|---------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------|------------------------|
| 2 pikë                      | 1 pikë                          | 1 pikë                          | 2 pikë                               | 6 pikë                 |
|                             |                                 |                                 |                                      |                        |



## TEST “GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI” AML

### Dokumentacioni zyrtar shkollor

1. Bazuar në udhëzimin për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve, kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim për parregullsitë gjatë zhvillimit të provimit ose për ndëshkimet që i janë dhënë nga administratori: **1 pikë**

- A) brenda 2 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
- B) brenda 3 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
- C) brenda 4 ditëve nga data e përfundimit të provimit.
- D) brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të provimit.

2. Vetëvlerësimi dhe analiza serioze, e detajuar dhe periodike e vetes mbi bazën e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm, i jep mësuesit një mundësi të çmuar për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta. Nivelet e arritjeve përmes të cilave mësuesit mund të bëjnë vetëvlerësimin dhe të përcaktojnë arritjen e kompetencës së tyre profesionale, janë: **1 pikë**

- A) dy.
- B) tre.
- C) katër.
- D) pesë.

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G).

- a) Komisioni i disiplinës në shkollë ngrihet në çdo fillim të vitit shkollor dhe kryesohet nga drejtori i institucionit arsimor. V/G \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) Komisioni i disiplinës në shkollë i merr vendimet me votim të hapur. V/G \_\_\_\_ **1 pikë**

### Programi lëndor

4. Për ndërtimin e kompetencave lëndore, nxënësi punon: **1 pikë**

- A) çdo orë mësimi.
- B) vetëm në disa orë të veçanta.
- C) vetëm gjatë një periudhe.

D) vetëm gjatë një viti mësimor.

5. Shënoni me V, nëse pohimi është i vërtetë, ose me G, nëse pohimi është i gabuar.

**3 pikë**

d) Programet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë mbështeten në dokumentet kryesore kurrikulare: Korniza Kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe planet mësimore të arsimit të mesëm të lartë.

\_\_\_\_\_

e) Në programet e klasës së dymbëdhjetë janë sugjeruar 16 orë mësimore për përgatitjen e nxënësve për provimin e Maturës Shtetërore. \_\_\_\_\_

f) Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënësve për çdo kompetencë kyç. \_\_\_\_\_

6. Përcaktoni kompetencat lëndore që u përkasin këto shkathtësi?

**2 pikë**

c) Nxënësi zgjedh format e përshtatshme për të përcjellë informacion për qëllime të ndryshme dhe dëgjues të ndryshëm.

\_\_\_\_\_

d) Nxënësi mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje, fakte dhe shembuj të përshtatshëm për qëllimin, lexuesin, kontekstin etj.

\_\_\_\_\_

### **Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë**

7. Vlerësimi i të nxënësve:

**1 pikë**

A) është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).

B) ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësve për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësve.

C) mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësve të mësojnë më mirë.

D) synon të zbulojë shkaqet e dobësive që kanë nxënësit në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

8. Gjatë planifikimit të testit, hapi i parë që duhet të kryejë mësuesi, është: **1 pikë**

- A) hartimi i skemës së vlerësimit të testit.
- B) përcaktimi i llojeve të pyetjeve dhe i pikëve që do të ketë testi.
- C) përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit.
- D) përcaktimi i rezultateve të të nxënit që do të vlerësohen në test.

9. Gjykoni si është formuluar dhe është pikëzuar pyetja e mëposhtme? Ç' lloj pyetjeje është ajo? **3 pikë**

Shkruani një arsye pse autori ka ndërthurur realen me fantastiken? Identifikoni dy momente të tilla në fragment.

*4 pikë*

- d) Formulimi i pyetjes:
- e) Pikëzimi i pyetjes:
- f) Lloji i pyetjes:

10. Zbatoni metodën e analizës së tipareve semantike për drejtimet letrare dhe veçoritë e tyre.

Shkruani dy përparësi të përdorimit të kësaj metode.

**3 pikë**

a) Analiza e tipareve semantike

|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

b) Dy përparësi:

11. Renditni tri arsye pse mësuesit duhet të përdorin *Google Forms*. **3 pikë**

12. Plotësoni pohimet e mëposhtme. **2 pikë**

c) Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse dhe e dorëzon në \_\_\_\_\_ para fillimit të periudhës.

d) Plani vjetor është një plan sintetik, ndërsa plani i periudhës është \_\_\_\_\_.

#### Aspekte të komunikimit dhe të etikës

13. Cila nga thëniet e mëposhtme përshkruan më mirë termin “Gjithëpërfshirje”? **1 pikë**

A) Është besimi se nxënësit duhet të veçohen sipas aftësive të tyre.

B) Është besimi se disa nxënës nuk mund të mësojnë.

C) Është filozofia që të gjithë nxënësit kanë të drejtë të marrin arsim të barabartë në një sistem arsimor.

D) Është filozofia që nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë për shkolla speciale.

14. Përcaktoni dy ndër parimet themelore mbi të cilat hartohet Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

#### Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

A) Këshilli Kombëtar i Prindërve

B) këshilli kombëtar i prindërve

- C) Këshilli kombëtar i prindërve
- D) Këshilli Kombëtar i prindërve

16. Nënvizoni fjalën që është shkruar gabim në fjalitë e mëposhtme.

**3 pikë**

- a) Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qendrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin e lartë ose për tregun e punës.
- b) Nxënësi deri në moshën njëzetë e dy vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar.
- c) Veprimtaritë plotësuse dhe ato jashtëshkollore që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument ku shënohet synimi i veprimtarisë dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.

## **Përmbajtja shkencore e lëndës**

### ***Pjesa e parë***

***“Ti po vjen që prej së largu” Lasgush Poradeci***

*(Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

Ti po vjen që prej së largu magjiplotë-dal-nga-dal  
Ti po vjen që prej së largu dyke shkitur mbi lëndina  
Nënë thembëzmat e tua përgëzohet trëndelina  
Shtrihet luleja mitare e zëmbakut që t’u fal

E si shkon me hap të matur më pushton një dhëmshuri  
Do të tretem, të kullohem në kalim të këmbës sate  
T’i pushtoj i llaftaruar ato hapëza mëkate  
Ndaj kalon mbi tufë lulesh madhërisht si yll i ri

Dhe të qaj me mall të rëndë poshtë teje pa pushim  
Poshtë fillit të poleskës ku do shkeli këmba jote  
Të të shtroj nga dhembja ime një çudi me pikash lote  
Një pluhurë të përvajshme vetëm dhembj’e dëshirim.

Të m’a shkelësh hije-letë, të m’a shkelësh mes –për-mes!  
Të të shoh si më lëkundesh me sy fjetur e fatuar,  
Brenda lotëve të mija të të shoh të pasqyruar,

E pastaj le të venitem, le të hesht e le të vdes.

*Ylli i zemrës (1937)*

17. Poezia përshkruan: **1 pikë**
- A) dashurinë si ndjenjë bipolare.
  - B) frikën e humbjes së vajzës.
  - C) peizazhin që frymëzon poetin.
  - D) portretin e vajzës si burim frymëzimi.
18. Muzikaliteti i strofës së parë krijohet nëpërmjet: **1 pikë**
- A) anaforës.
  - B) asonancës.
  - C) epiforës.
  - D) përsëritjes artistike.
19. Epiteti tipik lasgushian “*të llaftaruar*”, ka kuptimin: **1 pikë**
- A) e dëshirës që lind nga mungesa.
  - B) e frikës së humbjes së të dashurës.
  - C) e mallit të poetit për vajzën.
  - D) e shkallës më të lartë të ndjenjës.
20. Cili tipar i poetikës së Poradecit gjendet në këtë poezi? **1 pikë**
- A) Përdorimi i heshtjes për të plotësuar të pathënën
  - B) Përdorimi i vizës mes fjalëve për të krijuar kompozita
  - C) Prirja për të aktivizuar arkaizmat dhe dialektalizmat
  - D) Prirja për të krijuar neologjizma
21. Si portretizohet objekti i dashurisë (vajza) në këtë poezi? Ilustroni mendimin tuaj me shembuj nga poezia. **3 pikë**

22. Poezia është shkruar në varg të gjatë. Si ndikon ky varg në ritmin e poezisë? **1 pikë**
23. Interpretoni imazhin që krijon poeti me krahasimin “*si yll i ri*”, duke pasur parasysh vlerën kuptimore të fjalës *yll* në poetikën lasgushiane. **2 pikë**
24. Shkruani një ngjashmëri mes kësaj poezie dhe poezisë së Naim Frashërit. Ilustroni përgjigjen me shembuj nga poezia. **2 pikë**
25. Çfarë ka të veçantë prapashtesa e fjalëve: *thembërzat, hapëzat*? Cili është funksioni i këtij përdorimi? **2 pikë**
26. Cila është figura stilistike mbi të cilën krijohet vargu i fundit i poezisë? Interpretoni funksionin e saj. **2 pikë**

### ***Pjesa e dytë***

#### ***Prirjet në raportim***

*(Lexoni me vëmendje tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

Prindërit luajnë rol të madh në shkollë dhe kanë të drejtën të marrin raporte të rregullta nga shkolla për arritjet e fëmijëve të tyre. Duke qenë se ata vetë kanë pasur përvojat e tyre shkollore në të shkuarën, prindërit kanë pritshmëri të caktuara për sa i përket formatit të raporteve dhe se çfarë është e rëndësishme të përmbajnë ato. Mund të ekzistojë gjithashtu një hendek i konsiderueshëm brezash midis përvojave të prindërve në shkollë dhe asaj që ofrohet tani në shkollë.

Sigurisht, format e reja dhe më komplekse të vlerësimit që përdoren sot, kërkojnë forma të reja raportimi (Wiggins, 1998; Mc Tinghe dhe Wiggins, 2004). Nga ana tjetër, ndryshimet në raportim nuk janë të mirëpritura nga prindërit, nëse u krijojnë ankthe të tjera. Shumica e studiuesve janë të një mendjeje për parimet bazë të raportimit që janë:

- procesi i komunikimit duhet të jetë i drejtë, në kohë, konfidencial dhe i qartë (Loyd, 1997);

- baza mbi të cilën bëhet vlerësimi i performancës së nxënësve duhet të bëhet e njohur dhe të jetë e besueshme;
- pesha relative që u jepet kategorive që përbëjnë notën përfundimtare, duhet të bëhet e qartë dhe të jetë uniforme për të gjithë nxënësit dhe mësuesit;
- çdo gjykim i përmbledhur që bëhet gjatë raportimit duhet të jetë i mbështetur nga fakte dhe të dhëna (Wiggins, 1998).

Një numër shkollash po i ndryshojnë tani llojet e komunikimeve që u dërgojnë prindërve. Dërgimi me postë i një raporti me një faqe, një herë në semestër, që ka qenë dikur forma e vetme e komunikimit me prindërit, tani ka ndryshuar rrënjësisht. Tani shkollat përdorin sa më poshtë:

- raporte të ndryshme me shkrim;
- takime/intervista prindër-mësues;
- takime informuese për prindërit (zakonisht mbrëmjeve);
- fletëpalosje që shpjegojnë kurrikulën apo procedurat e reja të vlerësimit;
- gazetën e shkollës.

*(Teksti është marrë nga libri “Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin” Colin J. Marsh)*

27. Cila nga fjalitë e mëposhtme e shpreh më mirë idenë kryesore të tekstit? **1 pikë**
- A) Prindërit kanë të drejtë të informohen rreth arritjeve të fëmijëve të tyre.
- B) Format e reja të vlerësimit të nxënësve kërkojnë forma të reja raportimi.
- C) Ndryshimet në raportim nuk janë të mirëpritura nga prindërit, nëse u krijojnë ankthe të tjera.
- D) Prindërit luajnë rol të rëndësishëm në shkollë.

28. Struktura e tekstit është: **1 pikë**
- E) e krahasim- kontrastit.
- F) e problem- zgjidhjes.
- G) e shkak- pasojës.
- H) e renditjes së dukurive.

29. Cila nga alternativat do të ishte një mbyllje e përshtatshme për këtë tekst? **1 pikë**



- A) Çdo shkollë përzgjedh nga format e mësipërme të raportimit, sipas specifikave dhe mundësive të saj.
- B) Prindërit duhet të përshtaten me format e reja të vlerësimit të arritjeve të fëmijëve të tyre.
- C) Prindërit dhe mësuesit duhet të përcaktojnë së bashku së si do të vlerësohen arritjet e nxënësve.
- D) Drejtoria shkollës duhet të përcaktojë formate dhe modele të detyrueshme për raportimin e arritjeve të nxënësve.

30. Fjala *i përmbledhur* është formuar me:

**1 pikë**

- A) përngjitje.
- B) nyjëzim.
- C) parashtesim.
- D) parashteso-prapashtesim.

31. Autori e kërkon ndryshimin nga shkollat dhe jo nga prindërit, në lidhje me raportimin e arritjeve të nxënësve. A e gjykoni të drejtë këtë zgjedhje? Pse?

**2 pikë**

32. Shtoni edhe një formë tjetër raportimi, përveç atyre që janë në tekst. Pse është e rëndësishme kjo formë?

**2 pikë**

33. Funkzioni i grupit emëror *për arritjet e fëmijëve të tyre* në fjalinë: “*Prindërit luajnë rol të madh në shkollë dhe kanë të drejtën të marrin raporte të rregullta nga shkolla për arritjet e fëmijëve të tyre.*”, është \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

34. Klasa (përfshirë llojin) e fjalës së nënvizuar në fjalinë: “*Mund të ekzistojë gjithashtu një hendek i konsiderueshëm brezash midis përvojave të prindërve në shkollë dhe asaj që ofrohet tani në shkollë.*” është \_\_\_\_\_.

**2 pikë**

35. Cili është funksioni sintaksor i fjalës së nënvizuar në fjalinë: “Baza mbi të cilën bëhet vlerësimi i performancës së nxënësve duhet të bëhet e njohur dhe të jetë e besueshme.”?

**1 pikë**

36. Ç’ lloj kallëzuesi ka në fjalinë: “Procesi i komunikimit duhet të jetë i drejtë, në kohë, konfidencial dhe i qartë.”?

**1 pikë**

### ***Pjesa e tretë***

#### ***Fragment nga fjala e Orhan Pamuk në ceremoninë e çmimit “Nobel” më 7 dhjetor 2006***

*(Lexoni me vëmendje fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.)*

Shkrimtari është një person i cili mbyll veten në dhomë, ulet pranë tavolinës dhe, i vetmuar, i kthehet brendisë dhe brenda hijeve të saj ndërton një botë të re me fjalë. Ky burrë – apo kjo grua – mund të përdorë një makinë shkrimi, mund të përfitojë nga lehtësia e një kompjuteri, apo të shkruajë me një penë në letër, siç kam bërë unë për tridhjetë vjet. Duke shkruar ai mund të pijë çaj apo kafe, apo të ndezë një cigare. Herë pas herë ai mund të ngrihet nga tavolina e punës për t’u hedhur një shikim nga dritarja fëmijëve që lozin në rrugë dhe, po të jetë me fat, drurëve dhe peizazheve, apo mund ta tretë shikimin mbi një mur të errët. Ai mund të shkruajë poezi, drama, apo romane, siç bëj unë. Të gjitha këto ndryshime vijnë pas detyrës vendimtare të të ulurit pranë tavolinës së punës dhe kredhjes durimplote përbrenda vetes. Të shkruash do të thotë që të shndërrosh këtë kredhje të brendshme në fjalë dhe ta bësh këtë me durim, me këmbëngulësi dhe me gëzim. Kur rri ulur pranë tavolinës sime, me ditë, me muaj, me vite, duke hedhur fjalë të reja, njëren pas tjetrës, në faqe të zbrazëta, ndihem sikur po krijoj një botë të re, sikur po sjell në jetë atë personin tjetër brenda meje, ashtu siç ndërton dikush një urë, apo një pallat, gur më gur. Gurët që përdorim ne shkrimtarët, janë fjalët. Duke i mbajtur ato në duar, duke ndier mënyrat se si secila prej tyre lidhet me të tjerat, duke i parë nganjëherë nga larg, nganjëherë pothuajse në përfaqim të gishtërinjve dhe majat e penës, duke i peshuar ato, duke i lëvizur sa andej-këtej, vit pas viti, me durim dhe shpresë, ne krijojmë botë të reja.

37. Ç'të veçantë ka perspektiva e rrëfimit në këtë fragment? Pse autori e ka bërë këtë zgjedhje?

**2 pikë**

38. Interpretoni këndvështrimin e autorit në lidhje me raportin e shkrimtarit me vetminë.

**2 pikë**

39. Referenti në këtë tekst është \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

### **Pjesa e katërt**

40. A ndikon madhësia e klasës (numri i nxënësve) në efektivitetin e një mësuesi? Argumentoni në formë eseje qëndrimin tuaj.

**6 pikë**

| <b>Idetë ose përmbajtja</b> | <b>Struktura dhe organizimi</b> | <b>Stili dhe origjinaliteti</b> | <b>Larmia dhe saktësia gjuhësore</b> | <b>Totali i pikëve</b> |
|-----------------------------|---------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------|------------------------|
| 2 pikë                      | 1 pikë                          | 1 pikë                          | 2 pikë                               | 6 pikë                 |
|                             |                                 |                                 |                                      |                        |

### **3.2.Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit**

Të gjitha hulumtimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktor përcaktues për arritjet e nxënësve. Për këtë arsye janë të rëndësishëm si formimi fillestar, ashtu edhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban dy modele orësh mësimore, një orë për AMU-në dhe një orë për AML-në, si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

### 3.2.1. Modele orësh mësimore

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit, më poshtë janë dhënë dy modele orësh mësimore për secilin nivel arsimor: AMU-në dhe AML-në. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

#### **GJUHË SHQIPE AMU**

**Lënda:** Gjuhë shqipe

**Klasa:** VI

**Tema mësimore:** Shiler “Vilhelm Tel” (ora e parë)

**Rezultatet e të nxënësve:**

Nxënësi:

- tregon brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore të tij;
- analizon personazhet e tekstit duke u ndalur te fjalët dhe veprimet e tyre;
- identifikon mesazhin e tekstit.

**Metodologjia:** bashkëbisedim, lexim me role, kllaster, diskutim, ditar dypjesësh etj.

**Situata e të nxënësve:** Teatri

#### **Organizimi i orës së mësimimit**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

##### **a) Bashkëbisedim**

Mësuesi

*Drama dhe teatri*

- A keni qenë ndonjëherë në teatër?
- Ç’ dramë ishte vënë në skenë?
- A ju ka pëlqyer? Çfarë ju ka bërë përshtypje më shumë?
- Po drama keni lexuar?
- Ju pëlqen më shumë të lexoni drama apo t’i shihni në teatër ose në televizion? Pse?

*Shkrimtari*

- A njihni ndonjë dramaturg?
- A keni dëgjuar për Shilerin? Po për dramën e tij?

**Ndërtimi i njohurive të reja**

### a) Prezantimi i pjesës së re

Mësuesi përmbledh ose plotëson informacionin e nxënësve për autorin (shumë pak të dhëna për jetën dhe veprën e Shilerit) dhe për dramën “Vilhelm Tel”.

### b) Leximi me role

Mësuesi ndan nxënësit sipas roleve. Pjesës tjetër që nuk do të lexojë, i kërkohet të japë gjykime në lidhje me interpretimin e shokëve të klasës. Lihen nxënësit për pak kohë që të familjarizohen me tekstin dhe më pas lexojnë me role pjesën.

### c) Pyetje rreth të kuptuarit të tekstit

- Ku zhvillohen ngjarjet në këtë dramë?
- Çfarë kërkoi Gesleri nga Teli?
- Cili ishte shkaku?
- A iu bind menjëherë Teli Geslerit?
- Si reaguan njerëzit e tjerë ndaj urdhrin të Geslerit?
- A u tërhoq Gesleri?
- Kush ishte Valteri?
- A u frikësua Valteri nga urdhri i Geslerit?
- A arriti ta qëllonte mollën Teli?

Çdo përgjigje e nxënësve shoqërohet me shembuj dhe detaje nga teksti.

### d) Tregim i brendisë së tekstit

- Cilën pjesë mund ta konsiderojmë si pikë kulmore të këtij teksti?
- Kush mund ta thotë brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore?

1-2 nxënës tregojnë brendinë duke u ndalur në pjesët kryesore (hyrja, zhvillimi dhe pika kulmore). Mësuesi vlerëson nxënësit për tregimin e brendisë së tekstit.

### e) Ilustrimet

Nxënësit diskutojnë rreth ilustrimeve në tekst:

*Ilustrimet plotësojnë apo ilustrojnë brendinë e tekstit? Pse?*

Mësuesi u kërkon nxënësve se çfarë do të shtonin ata më shumë në këto ilustrime.

### f) Mesazhi i tekstit

*Ditari dy pjesësh*

Nxënësit punojnë në çift për formulimin e mesazhit të tekstit. Ata prezantojnë para të tjerëve mesazhin, duke argumentuar mendimin e tyre.

| <i>Pyetja</i>                      | <i>Përgjigja</i>   |
|------------------------------------|--|
| Cili është mesazhi i këtij teksti? | <i>Shembull përgjigjeje:</i> Forca e njeriut qëndron jo te pozita shoqërore, por te karakteri dhe cilësitë shpirtërore të tij) |

### g) Analiza e personazheve

- Sa personazhe ka në këtë tekst? Cilët janë ata?
- Për cilin personazh doni të diskutojmë më parë? Pse?

#### Teli

- Ç' tipare ka Teli? (trim, i mençur, i dashur, i vendosur, kryengritës – fsheh edhe një shigjetë tjetër dhe nëse do t'i ndodhte diçka djalit, atëherë do të vriste Geslerin, fisnik etj.)
- A u përpoq Teli të bindte Geslerin? Ç' rrugë ndoqi? (i kujton që një prind nuk mund të qëllojë mbi kokën e të birit, duke menduar se do ta prekë në pikën e tij të dobët)
- Pse Teli vendosi ta qëllojë mollën mbi kokën e të birit? (deshti të provonte papërkulshmërinë e njerëzve të thjeshtë). Telit ia njihnin që të gjithë zotësinë si luftëtar. Ai nuk ishte frikacak sepse nuk iku dhe as iu përgjyrua Geslerit. Teli, gjithashtu, nuk ishte mendjemadh dhe i pashpirt- duart që i dridhen, lutja që i bën Geslerit, sytë që i zgurdullon etj.
- Si e shfaq ai epërsinë e tij në raport me sundimtarin? (E qëllon mollën mbi kokën e të birit duke treguar kështu vlera fizike dhe shpirtërore)
- Çdo të kishit bërë në vend të Telit? Argumentoni zgjedhjen tuaj.

#### Gesleri

- Ç' tipare ka Gesleri?
- Ku duket mizoria e tij?
- Si e përfytyron Geslerin? Të bukur apo të shëmtuar?
- Gesleri ka vendosur që sa herë të përmendet emri i tij, njerëzit të varin kapelën e tyre mbi një hu. Si e gjykoni një veprim të tillë? Pse ju duket pa kuptim?
- Çfarë cilësish duhet të ketë që sundimtar që të meritojë nderimin dhe respektin e popullit të tij? Cili është mendimi juaj?

#### Valteri

- Si vizatohet Valteri? (trim, krenar, i pjekur për moshën e tij)
- Ku duken këto cilësi?
- Çfarë vlerësoni më shumë te ai?

- Ç' do të kishit bërë në vend të tij?

**Shënim:** Të gjitha cilësitë konkretizohen me detale nga teksti.

#### h) Diskutim

Mësuesi krijon mundësi që nxënësit të shohin një fragment në you tube nga drama “ Vilhelm Tel”.

[www.bing.com/videos/search?q=vilhelm+tel+video&docid=607990326886085853&mid=893F42C9295891368C7D893F42C9295891368C7D&view=detail&FORM=VIRE](http://www.bing.com/videos/search?q=vilhelm+tel+video&docid=607990326886085853&mid=893F42C9295891368C7D893F42C9295891368C7D&view=detail&FORM=VIRE)


- Si i kishit imagjinuar personazhet e këtij teksti? Ku ndryshon Teli, Gesleri dhe Valteri i fragmentit që pamë, nga Teli, Gesleri dhe Valteri i imagjinatës suaj?

#### Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

##### a) Kllaster i personazheve

Vizatoni kllasterin e tri personazheve të mësipërme

P.sh., Teli dhe Gesleri



##### b) Reflektim

- A ju pëlqeu ky tekst? Pse?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë?
- Nëse do të shoqërohej me muzikë kjo pjesë, ç' lloj muzike do të ishte ajo? Pse?
- A do t'u pëlqente ta interpretonit me role?
- Çfarë mund të bëjë secili prej jush?

##### Detyrë shtëpie

Mësuesi ndan nxënësit me grupe (regjisori, grupi që do të interpretojë rolet, grupi që do të merret me skenën, grupi që do të merret me kostumet, grupi që do të zgjedhë muzikën në sfond etj.) dhe kërkon nga nxënësit që javën e ardhshme ta vënë në skenë tekstin.

### **Vlerësimi**

*Niveli 2:* Nxënësi u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit, analizon tiparet kryesore të personazheve.

*Niveli 3:* Nxënësi tregon brendinë e tekstit me fjalor të thjeshtë, analizon personazhet duke u ndalur kryesisht në fjalët e tyre dhe identifikon me ndihmën e mësuesit, mesazhin e tekstit.

*Niveli 4:* Nxënësi tregon me fjalor të pasur brendinë e tekstit duke u ndalur në pjesët kryesore të tij, analizon personazhet e tekstit duke u ndalur te fjalët dhe veprimet e tyre, si dhe identifikon mesazhin e tekstit.

## **LETËRSI AML**

**Lënda:** Letërsi

**Klasa:** XII

**Tema mësimore:** Studim teksti “Bisedë me kafetarin” Ismail Kadare

*Nxënësi:*

- demonstroi të kuptuarit e tekstit;
- jep gjykimet e tij rreth ideve kryesore të tekstit;
- analizon veçoritë kryesore të gjuhës së tekstit.

**Metodologjia:** diskutim, imagjinatë e drejtuar, DRTA – lexim i drejtuar, ditar dypjesësh.

### **Organizimi i orës së mësimit**

#### **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

*Imagjinatë e drejtuar*

Përmes imagjinatës së drejtuar, në bashkëveprim me nxënësit ndërton një diskutim për ta bërë sa më reale situatën e të nxënësve:

*Imagjinoni sikur miku juaj më i ngushtë, me të cilin ju shprehni lirisht, zotëron një kafene në të cilën ju shkoni shpesh. Çfarë do të diskutonit rreth aktualitetit politik?*

#### **Ndërtimi i njohurive të reja**



**Të kuptuarit:** DRTA – Lexim i drejtuar

Nxënësit lexojnë pjesë- pjesë tekstin. Në fund të çdo pjese përmbledhin brendinë e saj, si dhe parashikojnë dhe argumentojnë vijimin e pjesës që vjen.

**Analizë teksti:** Punë në grupe

Gjatë kësaj faze ndahet klasa në dy grupe në punën me studimin e tekstit.

*Grupi 1:*

- Përcaktoni arsyet pse i pëlqen kafeneja e Mark-Alemit duke u ndalur në dhënien e shembujve në tekst.
- Duke u mbështetur në tekst, argumentoni dhe diskutoni:
  - A u referohen të gjitha të dhënat mjediseve të botës osmane? Sa prej tyre iu afrojnë me kohën e Perandorisë Osmane dhe sa ju largojnë?
  - Sa dhe cilat prej tyre do t’ju krijonin analogji në kohë? Cilën kohë/kohëra? Cilën hapësirë/hapësira?

*Grupi 2:*

- Ndaluni në përshkrimin e të verbuarve që vijnë në kafene dhe argumentoni ndikimin që kanë në të.
- Mbështetuni në fragment për të argumentuar se cilit sistem i referohet më shumë autori: totalitarizmit komunist apo botës osmane?

**Gjuha e tekstit:** ditar dypjesësh, punë e pavarur në grupe

**Grupi 1:**

*Gjuetia e sykëqinjve – si do ta emërtonit këtë figurë? Arsyetoni si është krijuar ajo.*

| Shprehja                    | Komenti |
|-----------------------------|---------|
| <i>Gjuetia e sykëqinjve</i> |         |

**Grupi 2:** *Komentoni fjalët e kafetarit: “E kupton tani pse nuk i dëboj dot nga kafeneja ime? E mbajnë veten me të madh për flijimin e syve. Kushedi si u duket vetja, pothuajse heronj.*

| Shprehja  | Komenti |
|---|---------|
| <i>E kupton tani pse nuk i dëboj dot nga kafeneja ime? E mbajnë veten me të madh për flijimin e syve. Kushedi si u duket vetja, pothuajse heronj.</i> |         |

## Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

### Diskutim

Nxënësit ndjekin 5 minuta, një fragment (minutat 7-13) nga një dokumentar për Atë Zef Pllumin. [https://www.youtube.com/watch?v=yqdTCQSG\\_Ko](https://www.youtube.com/watch?v=yqdTCQSG_Ko)

Mësuesi udhëheq diskutimin nëpërmjet pyetjeve:

- Çfarë ju bëri përshtypje nga ky dokumentar?
- Të ndëshkosh ata që shohin ose mund të shohin më larg a më qartë se të tjerët - çfarë dukurie është kjo?
- Cila është arsyeja më e fortë për goditjen e inteligjencës në sistemet totalitare? Kush do iu kundërviej më fort politikave shtypëse të një shteti tiran: shtresa e inteligjencës apo pjesa e popullsisë që është e paguximshme, e paditur dhe e tulatur nga ideologjia?

### Detyrë shtëpie

Shkrim i lirë: Argumentoni se pse tjetërsohet individi përballë sistemeve totalitare?

### Vlerësimi

*Niveli 2:* Nxënësi u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit dhe gjykon me ndihmën e mësuesit disa nga idetë kryesore.

*Niveli 3:* Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit, por ka pak vështirësi në kuptimin dhe gjykimin e ideve të nënkuptuara. Nxënësi analizon disa veçori të gjuhës së tekstit.

*Niveli 4:* Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit, jep gjykimet e tij rreth ideve kryesore të tekstit dhe analizon veçoritë kryesore të gjuhës së tekstit.

### 3.2.2. Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore, për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

#### Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

| Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur  |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|
| Gjithsej 70 pikë  |  |  |  |  |
| Përshkruesit  | Niveli 1 - Dobët   | Niveli 2 – Mjaftueshëm   | Niveli 3 – Mirë  | Niveli 4 – Shumë mirë  |
| <b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>   |  |  |  |  |
| <b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve.</b> | <b>0 – 1 pikë</b><br><i>Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e nxënësve. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i> | <b>2 – 3 pikë</b><br><i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënësve sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të nxënësve (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk është i lidhur me stilet e nxënësve. Pyetjet në</i> | <b>4 pikë</b><br><i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënësve sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e nxënësve. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i> | <b>5 pikë</b><br><i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënësve sipas programit lëndor. Gjithashtu mësuesi ka planifikuar situatë të nxënësve, të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN-të dhe me stilet e nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i> |

|   |  |  |  |   |
|---|--|--|--|---|
|   |  | <i>përgjithësi janë sipas niveleve.</i>  | <i>llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>   |   |
| <b>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore.</b> | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>                                      | 2 – 3 pikë<br><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>                  | 4 pikë<br><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara përqendrohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i> | 5 pikë<br><i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i> |
| <b>Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)</b>  |  |  |  |   |
| <b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, nxënësit trajtohen në mënyrë barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.</b>  | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i> | 2 – 3 pikë<br><i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i> | 4 - 5 pikë<br><i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>   | 6 - 7 pikë<br><i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>  |
| <b>Mësuesi angazhon dhe</b>   | 0 – 1 pikë   | 2 – 3 pikë   | 4 - 5 pikë   | 6 - 7 pikë  |

|  |  |   |  |  |
|--|--|---|--|--|
| <p><b>përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</b></p> | <p>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</p> | <p>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</p> | <p>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</p> | <p>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese, si dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</p> |
| <b>Metodat mësimore (21 pikë)</b>  |  |   |  |  |
| <p><b>Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të nxënësve.</b></p>   | <p>0 – 1 pikë<br/>Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së përzgjedhur dhe demonstroi që nuk i njej stilet e të nxënësve. Ora e mësimit është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</p>   | <p>2 – 3 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që i njej stilet e të nxënësve të tij, por ora e mësimit është tradicionale pa u kujdesur që nxënësve të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të nxënësve.</p>   | <p>4 - 5 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që i njej stilet e të nxënësve të tij, por metodat e teknikave që përdor në orën e mësimit nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësve të përmirësojnë arritjet e tyre.</p>  | <p>6 - 7 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që njej shumë mirë stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësve duke u dhënë mundësi nxënësve të përmirësojnë arritjet e tyre.</p>  |
| <p><b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).</b></p>  | <p>0 – 1 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u përqendruar më shumë vetëm tek ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës</p>   | <p>2 – 3 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u përqendruar më shumë vetëm tek ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës</p>  | <p>4 - 5 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësuesi përdor ndonjë metodë apo teknikë që nxit mendimin kritik dhe krijues te nxënësve, por vetëm disa</p>  | <p>6 - 7 pikë<br/>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësuesi përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues te nxënësve,</p>   |

|   |   |   |  |  |
|---|---|---|--|--|
|   | <i>mësimore, mësuesi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>  | <i>mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>   | <i>nxënësve u jep mundësi të diskutojnë gjatë orës së mësimit.</i>   | <i>që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen gjatë orës së mësimit.</i>  |
| <b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe të llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</b> | <i>0 – 1 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe të niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i> | <i>2 – 3 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i> | <i>4 - 5 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu mësuesi nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>     | <i>6 - 7 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe pyetje njëri – tjetrit.</i>  |
| <b>Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)</b>  |   |   |  |  |
| <b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.</b>        | <i>0 – 1 pikë</i><br><i>Mësuesi e përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>   | <i>2 – 3 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>  | <i>4 - 5 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai e përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i> | <i>6 - 7 pikë</i><br><i>Mësuesi demonstroi se e përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij, si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i> |



|   |   |  |   |  |
|---|---|--|---|--|
| <b>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.</b> | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i> | 2 – 3 pikë<br><i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes dhe në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>                   | 4 pikë<br><i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes dhe në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>                           | 5 pikë<br><i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes dhe rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>                              |
| <b>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve.</b>                     | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësit apo nevojat e nxënësve.</i>                         | 2 – 3 pikë<br><i>Mësuesi demonstroi se njih nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>                                      | 4 pikë<br><i>Mësuesi demonstroi se njih nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>  | 5 pikë<br><i>Mësuesi demonstroi se njih nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.</i>   |
| <b>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)</b>   |   |  |   |  |
| <b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore.</b>   | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësit të temës mësimore.</i>                                 | 2 pikë<br><i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore.</i> | 3 pikë<br><i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i> | 4 pikë<br><i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i> |
| <b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</b>  | 0 – 1 pikë<br><i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore.</i>  | 2 pikë<br><i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por përmbajtja nuk lidhet shumë me</i>  | 3 pikë<br><i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore, por</i>   | 4 pikë<br><i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin</i>  |

|  |                                  |  |  |   |
|--|----------------------------------|--|--|---|
|  | <i>nxënit të temës mësimore,</i> | <i>rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i> | <i>nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i> | <i>e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i> |
|--|----------------------------------|--|--|---|